



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA SHKODËR

GERMIN

Nr. 13097 Prot
Shkodër, më 30.6.2025

Nr. _____ Prot
Shkodër, më _____. _____. _____

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

BASHKIA SHKODËR, me adresë: Rr. "13 Dhjetori", Nr. 1, këtej e tutje e quajtur "Bashkia" me Kryetar Z. Benet Beci, përfaqësuar në këtë marrëveshje me vendim delegimi nga Zv/Kryetar Z. Rudin Beka, me adresë: "Rruga 13 Dhjetori, Nd. 9, H 1, Shkodër, 4001, Shqipëri", referuar në vijim si "Bashkia"

dhe

Organizata "**GERMIN**" me seli ligjore në Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, 8/3 Tiranë; regjistruar si person juridik, organizatë jofitimprurëse me nr. 6533 datë 17.09.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT M02302456F përfaqësuar nga z. Lirim Krasniqi dhe znj. Sihana Bejtullahu, në cilësinë e Bashkë - drejtorëve Ekzekutivë të "GERMIN", referuar në vijim si "**Organizata**".

Palët e kësaj Marrëveshje në vijim do të referohen së bashku si "**Palët**" dhe veçmas si "**Pala**".

Duke shprehur vullnetin dhe vendosmërinë për bashkëpunim dhe kontribut, palët bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, e cila do të përqendrohet në tri fusha kryesore: zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të programit 'OriginAL', realizimin e projekteve që

angazhojnë profesionistët shqiptarë të diasporës në mbështetje të zhvillimit të qytetit të Shkodrës, si dhe bashkëorganizimin e projektit ‘Invest in Shkodër’.

Germin është një organizatë joqeveritare që përdor kanalet virtuale për të lidhur dhe angazhuar Diasporën në avancimin e zhvillimit dhe demokratizimit të vendeve të tyre amë. Palët angazhohen për të bashkëpunuar me njëra-tjetrën duke rënë dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (si më poshtë “Marrëveshja”) sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1 Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në ligjin nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurese” i ndryshuar,

Neni 2 Objekti i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Palëve për zbatimin e iniciativave dhe projekteve të përbashkëta në fushat e mëposhtme:

1. Koordinimin dhe bashkëveprimin ndërmjet palëve me qëllim krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin dhe efektshmërinë e aktiviteteve;
2. Zhvillimi i planit të punës për realizimin e aktiviteteve;
3. Përdorimi i potencialit të diasporës profesionale për mbështetje teknike dhe këshillimore;
4. Promovimi i investimeve dhe zhvillimi ekonomik vendor përmes platformës “Invest in Shkodër”;
5. Bashkëorganizimi i aktiviteteve kulturore dhe edukative përmes programit “OriginAL”.

Neni 3 Fushat e Bashkëpunimit

2.1. Mbështetje për projektimin arkitektonik me profesionistët e diasporës

GERMIN angazhohet të:

- Hapë thirrje publike për profesionistët e diasporës për të mbështetur me ekspertizë fushën e arkitekturës dhe planifikimit urban në Shkodër.
- Organizojë sesione mentorimi dhe panele konsultative me ekspertë ndërkombëtarë.

Bashkia Shkodër angazhohet të:

- Identifikojë nevojat dhe projektet potenciale që mund të përfitojnë nga përfshirja e profesionistëve të diasporës.
- Facilitojë takimet dhe bashkëpunimin institucional.

2.2. Iniciativa “Invest in Shkodër”

GERMIN dhe Bashkia bien dakord të bashkëpunojnë për:

- Zhvillimin e një platforme për promovimin e investimeve dhe historive të suksesit.
- Bashkëfinancimin e fazës së parë të projektit me një buxhet orientues
- Organizimin e një forumi të dedikuar për diasporën ekonomike.

2.3. Programi “OriginAL” në Shkodër

Bashkëpunimi në organizimin dhe zhvillimin e programit ‘OriginAL’:

- a. OriginAL është një program i ri i nisur nga GERMIN dhe Fondacionit Global Shqiptar (Global Albanians Foundation), i cili synon të ofrojë një përvojë vullnetare, arsimore dhe kulturore për të rinjtë shqiptarë të Diasporës (18-24 vjeç) në vendet e tyre të lindjes. Qëllimi është të forcohet ndjenja e tyre e identitare dhe të krijojë lidhje afatgjata, veçanërisht mes tyre dhe bashkëmoshatarëve të tyre në vendet e origjinës. Në vitin e tij të parë (2022), OriginAL do të sjellë të paktën 40 të rinj shqiptarë nga e gjithë bota për dy javë në Shqipëri dhe Kosovë, për të rritur këtë numër në qindra e më pas mijëra të rinj shqiptarë nga e gjithë bota në pesë vitet e ardhshme.
- b. OriginAL synon të ofrojë një udhëtim edukativ dhe kulturor që përfshin përvojë vullnetare, që do të motivonte të rinjtë shqiptarë të diasporës për të eksploruar dhe për tu lidhur me shqiptarët në vendet tona amë. Ne jemi ambiciozë për të krijuar një histori suksesi të lidhjes kuptimplotë të të rinjve shqiptarë me vendet e tyre të origjinës dhe kjo histori fillon tani.

GERMIN angazhohet të:

- Përfshijë Shkodrën si një nga destinacionet për grupet e programit OriginAL në qershor dhe gusht 2025.
- Sigurojë logjistikën, organizimin dhe selektimin e pjesëmarrësve.

Bashkia Shkodër angazhohet të:

- Bashkëorganizojë aktivitetet lokale (si vizita kulturore, takime informuese, përfshirje në projekte komunitare).

Neni 4 Përgjegjësitë e Palëve

GERMIN:

1. Koordinon proceset e përfshirjes së profesionistëve të diasporës.
2. Promovon iniciativat përmes kanaleve të saj digjitale dhe rrjeteve globale.
3. Siguron dokumentim dhe raportim për ecurinë e bashkëpunimit.

Bashkia Shkodër:

1. Mbështet në lehtësimin e aktiviteteve dhe identifikimin e nevojave prioritare.
2. Jep kontribut financiar ose logjistik kur është e mundur sipas legjislacionit në fuqi.
3. Cakton një pikë kontakti për komunikim me GERMIN.

Neni 5

Kohëzgjatja dhe Rinovimi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe është e vlefshme deri më 31 maj 2026.
2. Palët mund të bien dakord për rinovimin e saj ose për modifikime, përmes komunikimit të shkruar dhe dakordësisë së ndërsjellë.

Neni 6

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike.
2. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njëra-tjetrën me qëllim bashkërendimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 7

Dispozita të Fundit

1. Çdo mosmarrëveshje në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim dhe dialog.
2. Palët në këtë marrëveshje udhëhiqen nga parimi i barazisë dhe përfitimit të ndërsjellë.
3. Palët vlerësojnë interesin e përbashkët për të ruajtur dhe zhvilluar formën e bashkëpunimit për të promovuar, organizuar dhe realizuar aktivitetet referuar kësaj marrëveshjeje.
4. Palët detyrohen ndërsjelltas të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me informacionin, të dhënat që do të shkëmbejnë gjatë vlefshmërisë dhe/ose zbatimit të kësaj marrëveshjeje, me vendimarrjen e përbashkët të tyre.
5. Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje, nga 2 (dy) kopje për secilën palë, të cilët pasi bien dakord e nënshkruajnë atë rregullisht.

PËR BASHKINË SHKODËR

Z. Benet BECI
Kryetar
ME VENDIM DELEGIMI
Zv/Kryetar

Z. Rudin BEKA



PËR ORGANIZATA GERMIN

Z. Lirim KRASNIQI

Znj. Sihana BEJTULLAHU